



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 205, Datë 13.09.2018**

**MBI**

***FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË  
RINOVUESHME NGA DIELLI ME FUQI TE INSTALUAR DERI 2 MW DHE ERA  
ME FUQI TE INSTALUAR DERI 3MW PER VITIN 2018***

Në mbështetje të nenit 10, pika 2 nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenet 19, 20, 21 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhur nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri MW për vitin 2018,

**Konstatoi se:**

- Në mbështetje të nenit 10 pika 2 dhe 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhur nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era me fuqi të instaluar respektivisht 2 MW dhe 3MW.
- VKM nr.369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhur nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhur nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

- Pika 2 e Vendimit Nr. 120 date 27.07.2017 te Bordit te ERE-s i cili miratoi çmimet per prodhuesit e vegjel nga dielli dhe era per vitin 2017 percakton se “Duke filluar nga viti 2018, per investimet ne vijim, ERE, ne baze te grumbullimit te te dhënave, persa i perket kostove reale te investimit, nese rezultojne te ndryshme nga parashikimet e VKM nr. 369 date 26.4.2017, “Per miratimin e metodologjise per percaktimin e çmimit te blerjes se energjise elektrike te prodhuar nga burimet e vogla te rinovueshme nga dielli dhe era”, t’i propozojë MEI-t per permiresimin dhe rishikimin e VKM”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për percaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi te instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi te instaluar deri 3MW per vitin 2018.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**